



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 54 dhe 64 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paragrafit 3.3 të Rregullës Zgjedhore nr. 06/2013 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, të Rregullës Zgjedhore 07/2013 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, dhe me qëllim të ngritjes së transparencës gjatë aktiviteteve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 21.10.2021, merr këtë:

VENDIM

Për Rritjen e Numrit të Vëzhguesve për Subjektet Politike që Mund të Vëzhgojnë Punën e Qendrës për Numërim dhe Rezultate për Zgjedhjet Lokale 2021

- I. Miratohet propozimi për rritjen e numrit të vëzhguesve nga i njëjti subjekt politik të akredituar në të njëjtën kohë për aq njësi të numërimit (tavolina të numërimit) që janë në QNR, në rast se ka edhe aktivitete tjera, lejohet nga e njëjta organizatë edhe dy vëzhgues shtesë për hapësira tjera.
- II. Miratohet propozimi për rritjen e numrit të vëzhguesve, nga i njëjta subjekt politik i akredituar që mund të jenë të pranishëm njëkohësisht për të vëzhguar punën në QNR gjatë procesit të numërimit dhe rinumërimit të jetë i barabartë me numrin e njësisive që zbatojnë numërimin dhe rinumërimin.
- III. Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim është e obliguar t'i njoftojë subjektet politike, që kanë akredituar vëzhgues për këtë vendim.
- IV. Qendra për Numërim dhe Rezultate, është e obliguar t'i njoftojë subjektet politike që kanë akredituar vëzhgues për pikën II të këtij vendimi para fillimit të aktiviteteve.
- V. Qendra për Numërim dhe Rezultate do t'u lejoj qasje vëzhguesve të përzgjedhur nga subjektet politike dhe që janë të pajisur me distinktiv të vëzhguesit nga KQZ-ja, për vëzhgim të plotë të aktiviteteve të QNR-së.
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.10.2021

Kryesues / Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

